



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 SHKURT 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. FEBRUARA 2013. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2013**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit,
3. Shqyrtimi i propozim-Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o proširenim nadležnostima za konfiskaciju imovine stečene krivičnim delom,
2. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L196 o sprečavanju pranja novca i sprečavanju finansiranja terorizma,
3. Razmatranje Predloga-Strategije i Akcionog plana protiv korupcije za godine 2013-2017.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në seancë janë të pranishëm 80 deputetë, me kartela 81. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Në këtë projektligj janë propozuar 2 amendamente.

Amendamenti numër 1 është propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, i përkrahur nga Komisioni Funkcional, ndërsa amendamenti 2 është propozuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara në projektligj.

Fjalën e ka kërkuar Arben Gashi. Urdhëro, deputet!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ky projektligj e ka marrë një kohë të gjatë në Komision dhe komisioni ka pasur debate të shumta dhe me gjithë konstatimet e shpeshta që ky projektligj nuk i plotëson kriteret minimale për të kaluar, ai ka kaluar dhe komisioni u ka dhënë përkrahje amendamentit 1 dhe amendamentit 2. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht po shpreh shqetësimin tonë për nevojën e kësaj Qeverie që t'i miratojë projektligjet në procedurë të përshpejtuar për shkak të disa vizitave të ndërkombëtarëve në Kosovë. Pra, ligjet nuk po bëhen për t'i luftuar krimin dhe korrupsionin, në këtë rast, nuk po bëhen në interes të qytetarëve dhe në interes të vendit, por për t'i treguar Bashkimit Evropian se - ja, ne i kemi miratuar këto ligje.

Pra, ne si Kuvend po mbetemi gjithmonë në nivelin e miratimit të ligjeve, jo për shkak se këto ligje po vijnë prej vullnetit të mirë të Ekzekutivit, por për shkak të vizitave të diplomatëve në Kosovë.

Ne nuk e kemi përvojën e mirë të miratimit të projektligjeve në mënyrë të përsheptuar dhe nëse veç e shihni agjendën legislative 2013, e vërejmë se 95% e ligjeve janë plotësim-ndryshim. Pra, krejt kjo si pasojë e miratimit të ligjeve për hir të dikujt, pa ndonjë analizë konkrete dhe sa për sy e faqe.

Është shumë e rëndësishme që ky Kuvend ta miratojë pakon ligjore kundër korrupsionit, mirëpo hartimi i këtij projektligji në këtë mënyrë, me këtë formë e me këtë përmbajtje, është amnisti e të gjithë atyre, të cilët janë përgjegjës e fajtorë për shkallën dhe nivelin e korrupsionit në Kosovë. Pra, e kam fjalën për këtë Qeveri dhe njerëzit që janë të ndërlidhur me të.

Unë po e tregoj pak rrjedhën e punës në Komisionin për Legjislacion për këtë projektligj. Komisioni e ka formuar grupin punues, të udhëhequr nga Behar Selimi, dhe për hir të gatishmërisë së opozitës dhe shoqërisë civile për të bërë amendamente, i njëjti nuk e ka lejuar, duke thënë se deputetët nuk kanë të drejtë të bëjnë ndryshime përmbajtjesore, por vetëm teknike.

Pas asaj mbledhjeje të dështuar, ne nuk jemi ftuar më në atë grup punues, e kjo tregon se kjo Qeveri e këta deputetë nuk janë të interesuar t'i luftojnë krimin dhe korrupsionin.

KRYETARI: Të lutem, për ligjin!

ALBULENA HAXHIU: Po, sigurisht! Unë po i përmendi pra edhe një herë vërejtjet konkrete të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe të shoqërisë civile për pakon ligjore antikorrupsion. E madje edhe shoqëria civile sot ka dalë në konferencë për media në lidhje me këtë projektligj. Prandaj, duhet të ndryshohet titulli i projektligjit, e të mos mbetet “Projektligji për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale”, por “Projektligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme”.

KRYETARI: Të lutem, diskutimi është pas kohës.

ALBULENA HAXHIU: Me Rregulloren e Kuvendit kemi të drejtë ta marrim fjalën për secilin projektligj.

Pasuria e përfituar në mënyrë të paligjshme duhet të vërtetohet nga i dyshuari, e jo sipas detyrës zyrtare. Ky projektligj do të duhej të zbatohet edhe për pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra të lejohet fuqia prapavepruese e tij.

E, asnjëra prej këtyre vërejtjeve nuk është përfshirë në këto amendamente. Madje Qeveria ka të drejtë që deri në shqyrtimin e dytë ta tërheqë këtë projektligj, andaj ne i bëjmë thirrje që ta bëjë këtë dhe ta sjellë një projektligj, i cili me të vërtetë i lufton korrupsionin

dhe krimin e organizuar, e jo që nëpërmjet këtij projektligji të legalizohen ato. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Mendoj se diskutimet për këtë janë kryer. Komisionet e kanë dhënë raportin me rekomandime dhe nuk e shoh të arsyeshme të diskutojmë, ndërkaq mendoj se votimi është ai që do t'i përcaktojë këto.

(Ndërhyrje)

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, debatet janë kryer, edhe në diskutimin në parim, edhe në komisione dhe ju njoftoj se ky ligj nuk miratohet me procedurë të përshpejtuar për faktin se tash e tre muaj ka ardhur në Kuvend. Domethënë, procedura e miratimit të ligjeve nuk është e përshpejtuar.

Mund që komisionet të kenë mbetur prapa dhe të kenë bërë procedura të përshpejtuara, por ky ligj është gati tre muaj në Kuvend dhe ka kaluar në leximin e parë, prandaj edhe i kemi dy amendamente.

Të pranishëm i kemi 98 deputetë dhe lus deputetët e regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Votojmë amendamentin 1.

Me 59 vota për, 15 kundër dhe 10 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Tash e kemi amendamentin 2. Votojmë tash!

Për amendamentin 2 kanë votuar 59 deputetë, 17 kundër dhe 11 abstenime.

Tani e votojmë ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 51 vota për, 33 kundër dhe 7 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet e Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në disa takime të mbajtura, e ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në të cilat janë ftuar përfaqësuesit e ministrisë sponsoruese, të Ministrisë së Financave, dhe përfaqësuesit e EULEX-it, të Komisionit Evropian, të Thesarit amerikan dhe i kemi propozuar 8 amendamente, të cilat janë proceduar për shqyrtim në komisionet tjera kryesore.

Me këto ndryshime janë rregulluar të gjitha çështjet që kanë qenë të nevojshme për ndryshim dhe plotësim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me nenin 3 të Projektligjit dhe të njëjtin nuk e ka pranuar, sepse komisioni i përmendur i ka bërë plotësim-ndryshimet e nevojshme në nenin 3 dhe ai është i harmonizuar me të gjithë faktorët relevantë, të cilët kanë marrë pjesë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Arsyeja pse ne kemi intervenuar në këtë amendament ka qenë se nuk janë përpunuar referencat e ligjit bazik dhe për këtë arsye është bërë plotësim-ndryshimi i këtij neni, kështu që ligjin bazik për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, ne vetëm e kemi qartësuar dhe kemi shprehur në mënyrë shumë të qartë se të gjitha veprat penale, të parapara me këtë projektligj, dhe veprat penale të parapara në ligjin bazik, hyjnë në kompetencat ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Në thelb nuk kemi bërë kurrfarë ndryshimi të nenit 3 të ligjit bazik, meqë siç ka qenë edhe në të, edhe në këtë projektligj veprat penale që kanë të bëjnë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit mbeten në kompetencë ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, para se të fillojë kjo seancë, i ka shqyrtuar edhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe i ka mbështetur vërejtjet e ngrehura lidhur me përkufizimin 2.1.42 dhe si rezultat e ka propozuar një amendament të ri, që është amendamenti 1, e që ka të bëjë me përcaktimin e saktë dhe në harmoni me Kodin Penal të Kosovës, të definicioni - “akt terrorist”, si në vijim:

Amendamenti 1.

Neni 1, përkufizimi 2.1.42 - “akt terrorist”, për qëllime të këtij ligji fshihet dhe zëvendësohet me përkufizimin: 2.1.42 - “akt terrorist nënkupton definicionin e përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës”.

Prandaj, i rekomandoj deputetët që ta miratojnë këtë amendament si amendamentin e parë, në bazë të rekomandimeve të cilat i kemi marrë nga Komisioni për Legjislacion.

Po ashtu, sipas rekomandimit të Komisionit për Legjislacion, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka rregulluar amendamentin 7, i cili tani bëhet amendamenti 8, pasi është shtuar amendamenti i ri 1, ku është ndryshuar referenca sipas Kodit të ri të Procedurës Penale.

Pra, amendamenti 7 tash bëhet amendamenti 8 dhe duket kështu:

Neni 22, paragrafi 2 riformulohet si në vijim:

Neni 32, paragrafi 2, rreshti 4, referenca - kapitulli 29, zëvendësohet me referencën - kapitulli 9.

Dhe, në fund, kërkoj nga Kuvendi që t'i miratojë amendamentet e propozuara dhe ta autorizojë Administratën e Kuvendit që të bëjë harmonizimin formalo-juridik të projektligjit sipas teknikës dhe standardeve të hartimit të legjislacionit. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Nga Komisioni për Legjislacion, kryetari Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe herën e kaluar nuk me dhe fjalën, megjithëse kisha të drejtë ta shpreh mendimin në emër të Grupit Parlamentar për ligjin që kaloi, sepse grupi ynë parlamentar ka votuar kundër. Kurse, për çështjet tjera do të flasë zoti Hamiti, e unë po flas për këtë ligj që tash e kemi në procedurë.

Komisioni e ka shqyrtuar ligjin dhe i ka vërejtur dy probleme kryesore. Problemi i parë është në amendamentin 7, që zonja Hadërgjonaj tha se e kanë përmirësuar. Referenca është e gabuar. Këtu bëhet referencë në kapitullin 29, ku realisht bëhet fjalë për kapitullin 9.

Dhe, një problem tjetër i identifikuar nga Komisioni për Legjislacion nga deputeti Haki Demolli, dhe i përkrahur nga komisioni, ka të bëjë me përkufizimin e aktit terrorist, dhe unë po i lexoj të dy variantet.

Sipas Ligjit të propozuar, thuhet: “Akt terrorist për qëllim të këtij ligji, nënkupton aktin që ka për qëllim t'i shkaktojë vdekje ose lëndime të rënda trupore një civili, ose ndonjë personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në një veprim, në një gjendje të konfliktit të armatosur, ku qëllimi i këtij akti në bazë të natyrës ose kontestit të tij është që ta frikësojë popullsinë ose ta detyrojë një qeveri, apo një organizatë ndërkombëtare që të kryejë një akt, apo të përmbahet nga kryerja e tij”.

Ne kemi propozuar që të mbetet siç është. Përkufizimi të bëhet sipas përkufizimit në Kodin Penal, i cili është më i saktë: “Terrorizëm, veprim terrorist, apo vepër e terrorizmit është kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit

serioz të popullsisë të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të qeverisë, apo organizatës ndërkombëtare për të kryer apo të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht t'i destabilizojë, ose t'i shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër, apo të një organizate ndërkombëtare”.

Dhe më poshtë i përmend të gjitha veprat penale që mund të realizohen.

Prandaj, si Komision për Legjislacion i kemi rekomanduar Komisionit FunkSIONAL që përkufizimi i aktit terrorist të merret nga Kodi Penal, sepse është më i saktë dhe besoj që do ta kemi edhe përkrahjen e gjithë deputetëve.

Këto ishin dy vërejtjet dhe Grupit Parlamentar i LDK-së do ta përkrahë. Unë fola në emër të Komisionit, por tash po e shfrytëzoj edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së për këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të dy gjërat që i the janë futur në amendamentin 1 dhe në amendamentin 8 në formën e re. Tash është shpërndarë dhe në amendamentin 1 thuhet:

“Neni 1.

Përkufizimi 2.1.42 “akt terrorist” për qëllimet e këtij ligji fshihet dhe zëvendësohet me përkufizimin: 2.1.42 “akt terrorist nënkupton definicionin e përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës”. Edhe amendamenti tetë është ashtu siç e ke kërkuar dhe ashtu e thotë varianti më i ri.

Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë vlerësoj si të rëndësishme për të thënë që asnjë nga këto amendamente, të cilat u paraqitën, si për ligjin që sapo u miratua, por edhe për këtë ligj nuk ka kaluar në Komisionin për Integritet Evropian. Ne kemi pasur një mbledhje të premtën dhe po atë ditë më vonë komisionet e tjera mund t'i kenë bërë këto amendamente. Kështu që në këtë komision nuk kanë kaluar dhe ne nuk kemi njohuri për këto amendamente.

Sa i përket amendamentit numër 3, i cili ka të bëjë me çështjen e kompetencave për Prokurorinë Speciale, ne si komision jem marrë vesh që të merret parasysh rekomandimi i Komisionit Evropian dhe kjo gjë është bërë. Domethënë është rekomandimi i Komisionit Evropian që është edhe sot në këtë amendament. Mirëpo, të gjitha të tjerat po kalojnë pa miratimin e Komisionit për Integritet Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zotëri kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë të nderuar,

Unë e kam një propozim dhe një sqarim.

Kryetari i Kuvendit tha që janë mbaruar diskutimet për këto probleme, sepse kanë kaluar nëpër komisione, por unë them 'jo'. As me Rregulloren e Kuvendit, jo. Po them jo, sepse dua ta shfrytëzoj edhe në këtë nivel, që është niveli më i lartë i Kuvendit në përbërje që ta jap një propozim pikërisht për këtë ligj, për të cilin po bisedojmë.

Propozimi im, që po e shfrytëzoj të drejtën, e kjo seancë vendos në finale për çdo gjë, një propozim që e kanë dhënë në leximin e parë. Edhe një herë insisto që në shqip ky ligj duhet të quhet: "Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit". Shqip duhet të jetë kështu. Ju lutem shumë!

KRYETARI: Kështu e lexuam edhe ne...

SABRI HAMITI: Kjo është vërejtje, në komisione kur nuk e kanë ndryshuar. Sot mund ta ndryshojnë dhe unë ju lus që ta ndryshojnë. Ky është propozimi im.

Shpjegimi i dytë ka të bëjë prapë me diskutimin a mund të flitet për amendamentet. Mund të flitet gjithmonë. Dhe, unë po ju them pse. Konkretisht ne i kemi në dorë dy rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Financa, një që mban datën 8.2.2013 dhe ky, që është i nxehtë, që e kemi tash, që na erdhi sot në tavolinë, 11.2.2013. Pra, vetë kjo tregon që është e pamundur të mos bisedohet në seancë për çdo germë, për çdo presë, për çdo fjalë.

Prandaj, sado që kryetarja e Komisionit, unë e dëgjova kujdesshëm, pak a shumë iu referua variantit të sotëm, megjithatë në interpretimet e dy komisioneve u pa që ka referenca në dy konkludime.

Shikoni, zoti kryetar!

Ju na i keni dërguar këto variante, unë i kam marrë, qysh jemi marrë vesh pas dite. Një rekomandim të tetëshit, të dyja janë të vlefshme, asnjëra nuk është anuluar, dhe një të njëmbëdhjetëshit. Nuk janë njësoj. Dhe tash nëse votoni, ju detyroheni të thoni, "po votojmë me dokumentin e 11-shit, sepse janë më shumë dhe nuk e kanë të njëjtin rend të amendamenteve". Unë nuk dua të bisedoj për këtë më tutje.

Unë mendoj që ligji duhet të kalojë, ndonëse i kam edhe vërejtjet e mia tjera, por është vonë dhe nuk dua të zgjerohem. Por, po them - kini kujdes! Në tavolinë i kemi dy referenca, sqaroheni me cilën referencë punojmë. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Referenca e fundit gjithmonë e eliminon të parën.

(Ndërhyrje e Sabri Hamitit: Përmendsh!)

Ju lutem! Mundësitë për të diskutuar dhe për t'i ndryshuar amendamentet konkrete gjithnjë janë të mundshme, por jo debatet. Debatet janë kryer, por propozimet janë të mira dhe kur e lexova pikën e dytë të rendit të ditës, ishte: "Shqyrtimi i dytë i Projektligjit

për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit”. Kështu e kam lexuar.

(Ndërprerje nga regjia)

Ju lutem, ky është vendimi dhe propozimi i seancës dhe ju të gjithë e dini, këtu keni qenë. Ka qenë propozim i seancës.

Të pranishëm 102 deputetë, me kartela 101.

A jeni që ligji të quhet: “Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit”

Kush është për? Faleminderit! shumica. A ka kundër. Nuk ka. Pra, u miratua ndryshimi i emrit të ligjit.

Vazhdojmë tash me amendamentet. Me propozimin e datës 11.02.2013, ora 13:55 minuta, i kemi 9 amendamente. A jeni dakord? E tash votojmë për amendamentin 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 96 vota për, asnjë kundër, një abstenim, miratohet amendamenti 1.

Në radhë e kemi amendamentin 2. Votojmë tash!

Me 94 vota për, asnjë kundër, një abstenim, miratohet amendamenti 2.

Në amendamentin 3, kemi dy propozime, propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe propozimin e Komisionit për Integritet Evropian.

Deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Arsyeja pse ka dalë një material i dytë ka qenë meqë në materialin të cilin e kemi marrë nga Komisioni për Legjislacion nuk i kemi pasur të riformuluara amendamentet sipas kërkesës së tyre.

Ata kanë bërë vërejtje që amendamentet e Komisionit Funkcional nuk e kanë bazën juridike për procedim të mëtutjeshëm, përveç amendamentit shtatë. Të njëjtën e kemi edhe në pikën 3. Prandaj, na është dashur t'i riformulojmë amendamentet dhe e kemi mbajtur mbledhjen e komisionit. Në orën 13:30 e kemi filluar mbledhjen dhe e kemi përfunduar materialin e ri, për t'i riformeluar amendamentet në bazë të kërkesës për legjislacion. Sa i përket emrit, ne e kemi diskutuar në komision dhe nuk jemi pajtuar për ta ndryshuar. Megjithatë, këtu u mor një vendim.

Tek amendamenti 3, unë i dhashë arsyetimet që Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk i ka përkrahur rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian. Megjithatë, për këtë amendament ne e kemi pasur një rekomandim nga Komisioni për Integritet Evropian. Arsyeja ka qenë se në amendamentin 3, referencat të cilat kanë qenë në ligjin bazik, nuk kanë qenë mirë të rregulluara. Dhe, ne jemi dakorduar edhe me faktorët relevantë, që këto referenca të rregullohen, sepse veprat penale janë të parapara me nenin 32 dhe 33 të ligjit bazik dhe njëkohësisht e kemi harmonizuar edhe me ligjin bazik, edhe me plotësimin e ligjit.

Prandaj, unë u kisha rekomanduar deputetëve, që amendamenti 3, që ka të bëjë me nenin 3, i riformuluar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, është përkrahur njëzëri nga ky komision dhe rekomandoj të përkrahet edhe në seancën plenare.

KRYETARI: Kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që Komisioni për Legjislacion i ka pasur këto vërejtje. Unë tash po e shoh materialin, se sapo erdhi para 10-15 minutash, ku është përfshirë edhe problemi i definimit të aktit terrorist. Mirëpo, unë nuk po i shoh këtu dy propozime. Këtu është vetëm një propozim.

Amendamenti 3 e ka një propozim dhe propozimi është: neni 3 riformulohet në me tekstin, si në vijim: “Veprat penale, sipas këtij ligji dhe ligjit bazik, hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e themeluar me Ligjin 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës”, ndërsa nuk ka një rekomandim tjetër të Komisionit për Integritet Evropian. Ku është ai rekomandim? Është dashur të jetë pjesë integrale e këtij dokumenti!

KRYETARI: Është rekomandimi i Komisionit për Integritet Evropian që neni të fshihet, por unë mendoj që më mirë është kjo si u lexua. Atëherë, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim! Votojmë amendamentin 3, të propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe të mbështetur nga Komisioni për Legjislacion.

Votojmë tash!

Me 80 vota për, 10 kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Në radhë e kemi amendamentin 4. Votojmë tash!

Me 90 vota për, asnjë kundër, një abstenim, miratohet amendamenti 4.

Në radhë e kemi amendamentin 5. Votojmë tash!

Me 93 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6. Votojmë tash!

Me 93 vota për, asnjë kundër, një abstenim miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7. Votojmë tash!

Me 94 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8. Votojmë tash!

Me 88 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9. Votojmë tash!

Me 94 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Tani, e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Të pranishëm 102 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 94 vota për, një kundër, një abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe për parandalimin e financimit të terrorizmit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i propozim-Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017

Në mbledhjen plenare, të mbajtur më 24 janar 2013, pas përfundimit të diskutimeve, Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Komisionin për Integritet Evropian që mbi bazën e diskutimeve në atë mbledhje plenare ta plotësojnë tekstin e propozim-Strategjisë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar propozim-Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar riprocetim të raportit me rekomandime të datës 24 janar 2013.

Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar propozim-Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, deputetin Arben Gashi, për arsyetimin e përfundimeve lidhur me propozimin e Strategjisë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Në bazë të rekomandimit të seancës plenare të datës 24 janar 2013, me të cilën u është kërkuar Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit për Integritet Evropian që ta plotësojnë Strategjinë dhe Planin për Veprim. Komisioni është mbledhur dhe ka vlerësuar se rekomandimi i seancës është i pabazë dhe nuk mund të veprohet ashtu, sepse deri më tani nuk ka praktika të plotësimit dhe të ndryshimit të strategjive, të cilat janë sjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, pas konsultimeve, komisioni ka konstatuar se është e paarsyeshme që të ndërhyhet në një dokumentacion, i cili nuk është kompetencë e Kuvendit që të draftohet dhe ndërhyrja do të ishte e dëmshme dhe do ta dëmtonte gjithashtu edhe Strategjinë, edhe Planin.

Si përfundim, komisioni, me përkrahjen e deputetëve të partive në pushtet, e ka përkrahur Strategjinë, ndërsa deputetët e opozitës kryesisht e kanë kundërshtuar. Kështu, kemi mbetur te rekomandimi i mëhershëm. Faleminderit!

KRYETARI: Meqë propozimi ishte i grupit tuaj parlamentar, i nënkryetarit, i mbështetur nga nënkryetari i Kuvendit...

(Ndërhyrje)

Ne këtu kemi qenë! Lexojini stenogramet dhe këto gjëra! Mos harroni, jemi këtu për të mos harruar shumë, se pak lejohet. Komisioni për Integritet Evropian, e do fjalën? Atëherë, fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Si pikë e parë, mendoj se u tha, mirëpo herën e parë kur e kërkoja fjalën, nuk ma dhatë dhe e ndërpretë.

Mendoj se është e drejtë që të diskutohet për çfarëdo pike, kur deputetët thirren për të votuar. Kemi të drejtë të provojmë, kam thënë disa herë në foltoren e Kuvendit. Kemi të drejtë të provojmë t'ia mbushim mendjen dikujt për të votuar për ose kundër, çfarëdo që hedhet në votim. Dhe, të paktën, kur u jepet fjala dy deputetëve, atëherë duhet t'u jepet edhe të tjerëve, sidomos kryetarëve të grupeve. Faleminderit për pjesën e parë.

Për pjesën e dytë, mendoj se në Kuvend disa herë po shndërrohet në normë që dokumentet të cilat vijnë prej institucioneve të pavarura, në mënyrë absolutisht jo të rregullt, të pretendohet të shkojnë në lexim të dytë, ose për përmirësime në Kuvend.

Këto dokumente nuk i bën Kuvendi. Kuvendi i miraton, ose nuk i miraton ato. Kemi pasur raste edhe më përpara kur ka ndodhur njëjtë. Mendoj se është e gabuar t'i dërgohet, ashtu siç tha edhe kryetari i komisionit, në fakt kjo është në 'eho' e asaj fillimisht. Është e gabuar t'i përcillet komisionit për përmirësim ose për plotësim një dokument, i cili nuk është dokument i Kuvendit. Kuvendi e miraton ose jo. Nuk e bën vetë. Ligjet janë diçka tjetër, për shkak se ligjet në demokraci konsiderohet se i bën Kuvendi, ndërsa i sponsorizon Qeveria.

Në lidhje me këtë kisha dashur të them se Kuvendi duhet ta ketë një qëndrim, se për çfarëdo dokumenti i cili duhet të miratohet në Kuvend, institucionet e pavarura duhet paraprakisht të kenë takime të rregullta me komisionet përkatëse për dokumentet e caktuara, në mënyrë që Kuvendi të jetë i informuar gjatë procedurës së hartimit të tyre, që të mos kemi nevojë pastaj të jemi në situata të tilla kur nuk na pëlqen dokumenti dhe në të njëjtën kohë nuk kemi çfarë të bëjmë tjetër.

Kjo është një thirrje për institucionet, mirëpo edhe për Kuvendin. Ndoshta do ta gjejmë mënyrën që ta kemi vendim këtë çështje, që gjatë hartimit, deputetët e komisioneve të jenë pjesë e diskutimit për dokumentet. Në këtë mënyrë, në Kosovë do të avancohet një proces demokratik dhe nuk do të arrijmë në situatat e këtilla.

Ne mendojmë se ky dokument që ka ardhur nuk është i mirë. Ne mendojmë se me këtë dokument, nëse bazohet në këtë dokument, Kosova për katër vjet nuk do të arrijë të bëjë hapa përpara në luftimin e korrupsionit.

E dimë sesa negative do të ishte nëse një dokument nuk kalon i këtillë, mirëpo po ashtu jemi plotësisht të vetëdijshëm se ndoshta një herë duhet të ndalohet ky cikël, që të mos na vijnë dokumente 'format', të përsëritura, ku ka vetëm klishe të proceseve të ndryshme. Nuk po flas vetëm për këtë dokument tani, mirëpo kur do të kemi dokumente, të cilat me të vërtetë do t'i ndihmojnë gjithë vendit për ta luftuar një dukuri tepër negative, e cila po na pengon në zhvillim.

Ne nuk mund ta votojmë këtë dokument, duke e ditur se çfarë ka në të, duke e ditur saktë se cilat do të jenë procedurat e mëturshme, dhe mendojmë se të gjitha institucionet duhet të mendojnë më mirë pra se t'ia sjellin Kuvendit dokumentet e përsëritura. Faleminderit!

KRYETARI: I kemi edhe dy diskutues. Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

U paraqita që t'i sqaroj dy çështje. E para, debati për Strategjinë dallon nga debati për ligjet dhe në Komisionin e ligjeve e kemi bërë këtë të qartë, për shkak se ajo nuk mund të amendamentohet. Ajo miratohet, ose hedhet.

Momenti i dytë që kjo është një Strategji e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e cila është e obliguar që në bazë të ligjit ta paraqesë strategji në Kuvend për miratim, e jo një strategji e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nuk është një strategji kombëtare, sepse zinxhiri i institucioneve kushtetuese dhe ligjore në luftën kundër korrupsionit është shumë më i gjerë sesa vetë Agjencia Kundër Korrupsionit, apo thënë më shkurt - kjo agjenci është vetëm një hallkë në zinxhirin e mekanizmave kombëtarë në luftë kundër korrupsionit.

Mirëpo, në bazë të ligjit për këtë agjenci, është paraparë që Strategjia i paraqitet Qeverisë, Qeveria e miraton dhe ia përcjell Kuvendit.

Është e vërtetë se Strategjia nuk është perfekte, por është një bazë e mirë dhe mendoj se ne duhet ta miratojmë për shkak se edhe në radhën e parë nuk e kemi miratuar atë. Është një element më relevant në raportin e studimit të fizibilitetit dhe nuk do të varet shumë lufta kundër korrupsionit me atë sesa është e mirë kjo strategji, por do të varet sa institucionet, që kanë detyrim kushtetues, i realizojnë detyrimet e veta. Kështu, unë propozoj që ta miratojmë edhe Strategjinë, edhe Planin e Veprimet, dhe të kërkojmë nga

të gjitha institucionet kushtetuese që t'i ushtrojnë të gjitha detyrimet karshi luftimit të korrupsionit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Realisht, është një defekt. Agjencia Kundër Korrupsionit është organ që i përgjigjet Kuvendit. Dhe, raporti i saj do të duhej të vinte në Kuvend, në rrugën e drejtpërdrejtë, e jo në rrugën që e ndjekin ata. Megjithatë, kjo është çështje e atyre që i drejtojnë këto institucione. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë do ta paraqes qëndrimin në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ky qëndrim do të rezultojë edhe me votën e deputetëve të pranishëm. Mendimi ynë nga seanca e kaluar nuk ka ndryshuar. Arsytet, siç janë thënë - kjo strategji nuk i përmbush kushtet, kriteret dhe pritjet tona për luftimin e korrupsionit, por edhe të krimit të organizuar në vend. Kjo është arsyeja kryesore pse ne nuk pajtohemi, ashtu siç kanë qenë edhe diskutimet e fundit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Është e vërtetë që Agjencia Kundër Korrupsionit është organ i themeluar nga Kuvendi, por në Ligjin mbi Agjencinë Kundër Korrupsionit, një nen thotë që Strategjia kalon nëpërmjet Qeverisë, e nuk miratohet nga Qeveria. Këtu është ai defekti që është pranuar nga Kuvendi i Kosovës, që thotë është miratuar nga Qeveria, ndërsa duhet vetëm të kalojë nëpërmjet Qeverisë sipas ligjit në fjalë.

Grupi Parlamentar i LDK-së rezulton me votën kundër për arsyet e përmendura dhe ne e ftojmë edhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, si organ i cili i raporton Kuvendit, të jetë më përgjegjëse edhe para vetë komisionit, i cili e mbikëqyrë punën e saj, por edhe në raport me organet tjera të pavarura.

E dyta, e fton edhe Qeverinë që të mos tentojë politizimin e organeve të pavarura, siç janë pjesa e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e cila lidhet edhe me Prokurorinë dhe Gjyqësorin. Kjo është ajo që ne kërkojmë pavarësi të plotë dhe besoj që gabimet e tilla nuk duhet të përsëriten në të ardhmen. Vota jonë do të jetë kundër.

KRYETARI: Faleminderit!

Më duhet ta them edhe një çështje në mënyrë decitive: nëse një deputet i Kuvendit të Kosovës mendon se korrupsioni do të luftohet nga Agjencia Kundër Korrupsionit, le ta dijë se ajo nuk do të ndodhë kurrë. Të gjithë e dimë se cilat janë institucionet që vërtet duhet ta luftojnë korrupsionin.

(Reagime nga salla)

Ajo më tepër është si agjenci për ta mediatizuar problemin, sesa për t'i zgjidhur problemet.

Fjalën e ka deputetja Albulenë Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç u tha nga grupet tjera parlamentare, kjo strategji nuk ka pësuar fare ndryshime dhe vendimi për ta kthyer në Komisionin për Legjislacion dhe për Integritet Evropian ka qenë vetëm sa për t'u hedhur hedhë hi syve qytetarëve se ja që tash komisionet e Kuvendit do të ndërmarrin masa në lidhje me të. Pra, kjo strategji është hartuar në mënyrën më të keqe të mundshme, ka shumë probleme në mënyrën e hartimit të saj, është bërë pa një qasje gjithëpërfshirëse, duke e përfshirë vetëm Qeverinë në këtë proces, e jo edhe subjektet opozitare, apo shoqërinë civile. Madje shoqëria civile ka qenë e përjashtuar nga hartimi i kësaj strategjie.

Gjithashtu më duhet të them se, nëse i analizojmë me vëmendje objektivat e kësaj strategjie, vërejmë se më tepër janë si fraza moralizuese sesa veprime konkrete për t'i luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Kjo strategji nuk e trajton gjithashtu korrupsionin në sektorin e prokurimit publik dhe në atë të privatizimit, pra në procesin e privatizimit, kur tashmë dihet shkalla e korrupsionit në këta dy sektorë. Pra, ne mbetemi në vërejtjet që i kemi thënë edhe në seancën e kaluar dhe nuk do ta votojmë, si dhe u bëjmë thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që të mos e votojnë këtë strategji. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm 104 deputetë. Lusë deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 54 vota për, 45 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017.

Mirupafshim në mbledhjen e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë